

THE ROLE OF INTERNATIONAL WORDS IN THE ACQUISITION OF FOREIGN LANGUAGE

ROLI I FJALËVE ME KARAKTER NDËRKOMBËTAR NË MËSIMIN E GJUHËVE TË HUAJA

Nikoleta KALLDRËMXHIU¹

¹*Qendra e Studimeve Albanologjike*

²*E mail nikoleay@yahoo.com*

Përmbledhje

Fjalët ndërkombëtare ndihmojnë në përvetësimin e gjuhës dhe nëpërmjet tyre, zbulimin e ndikimeve kulturore të kaluara dhe të sotme. Reflektimi gjuhësor i tyre në ndryshimet sociale, vitet e fundit është pasqyruar sidomos të globalizmi dhe internationalismi. I pranishëm kudo, veçanërisht në arsimin e lartë, globalizmi ka rritur gjerësisht kërkesën, që studentët të kërkojnë programe të cilat i mundësojnë të lëvizin lirish. Kjo në rradhë të parë lidhet me zgjerimin e përvojës gjuhësore dhe njohurive gjuhësore, për të kuptuar leksikon akademik, si dhe popuj, kultura e vende të ndryshme, duke krijuar një forcë intelektuale të lëvizshme. Kërkesa të tilla çojnë në module të reja mësimdhënie, siç është përvetësimi e fjalëve ndërkombëtare dhe ato të njëjta në të paktën tri gjuhë të së njëjtës familje gjuhësore.

Ky artikull ndihmon jo vetëm për të mbajtur një qëndrim të ri ndaj fjalëve ndërkombëtare si pjesë e trashëgimisë botërore, por edhe si shërbyese apo thënë ndryshe katalizator në mësimin e gjuhëve të huaja dhe ndjeshmërisë gjuhësore të individit. Fjalë ndërkombëtare, si: aspekt, autonom, kronik, aprovoj, aksion, konstant, ekstrakt, kontemporan, transport, zhargon, energjik, mit, potencial, turbulent, vital, karizma, spontan, humor, absurd, unik, propozoj brillant etj janë një shembull i çka më sipër vijua. Të paraqitura një tabelë multilinguale, ku fjalët ndërkombëtare të TOEFL test janë paraqitur me homologet e tyre në gjuhën italiane, franceze, gjermane dhe rumune. Përveç përkufizimit të ndërkombëtarizmave dhe kriteret e pranimi të tyre, kemi sqaruar traditën, bashkëkohësinë e tyre si dhe përzgjedhjen e gjuhëve në punim.

Gjuha njerëzore është një kod dhe sa më shumë fjalë çelës të saj të zbulojmë, aq më shpejt arrijmë idealin e njeriut modern të mësuar, që mendohet të jetë të paktën tringua. Njohja dhe mësimi i gjuhëve evropiane në arsimin paeuniversitytar dhe universitar lehtëson në rradhë të parë mësimin e fjalorit akademik. Përvoja gjuhësore të nxënësve janë paraqitur në botime të tilla, siç është Portofoli i European i Gjuhëve në AML në Republikën e Shqipërisë, duhet të zgjerohen me shënime të nxënësve mbi ngjashmëritë gjuhësore, që ai vëren në gjuhët e mësuara, që ndihmojnë si atë vetë, ashtu edhe studiuesin e gjuhës. Si pjesë e gjuhësisë së zbatuar rezultati i plotë i këtij mëtimi, mund të ishte një libër, në secilin fjalë e shqipes do të vihesh me homologet e saj, bashkë me përshkrimin, kuptimet dhe etimologjinë.

Fjalë kyçe: *ndërkombëtarizma, globalizëm, kod, e lëvizshme*

Abstract

International words help in the acquisition of the language and through them, the discovery of past and present cultural influences. Their linguistic reflection in social changes, in recent years, has been reflected especially in globalism and internationalism. Present everywhere, especially in higher education, globalization

has greatly increased the demand for students to seek programs that allow them to move freely. This is primarily related to the expansion of linguistic experience and linguistic knowledge, to understand the academic lexicon, as well as different peoples, cultures and countries, creating a mobile intellectual force. Such requirements lead to new teaching modules, such as the acquisition of international words and the same ones in at least three languages of the same language family.

This article helps not only to maintain a new attitude towards international words as part of the world heritage, but also as a service or in other words a catalyst in the learning of foreign languages and the linguistic sensitivity of the individual. International words, such as: aspect, autonomous, chronic, approve, action, constant, extract, contemporary, transport, jargon, energetic, myth, potential, turbulent, vital, charisma, spontaneous, humour, absurd, unique, propose brilliant, etc. are an example of what we followed above. A multilingual table is presented, where the international words of the TOEFL test are presented with their counterparts in Italian, French, German and Romanian. In addition to the definition of internationalisms and their acceptance criteria, we clarified their tradition, contemporaneity and the selection of languages in the paper.

Human language is a code and the more its key words we discover, the sooner we reach the ideal of the learned modern man, who is thought to be at least brave. Knowing and learning European languages in non-university and university education facilitates the learning of academic vocabulary in the first place. The linguistic experiences of the students are presented in such publications as the European Language Portfolio of the AML in the Republic of Albania, should be expanded with the student's notes on the linguistic similarities that he notices in the languages learned, which help as his own, as well as the language researcher. As part of the applied linguistics, the full result of this study could be a book, in each word of Albanian you will find its counterparts, together with the description, meanings and etymology.

Keywords word: *internationalism, code, globalism, mobile*

1. Hyrje

Mësimi i gjuhëve të huaja është mundësia që i jepet çdo individ të prodhojë një mendje të hapur dhe akademike. Në botën e sotme moderne kjo vlen si përfitim në marrëdhëniet social-ekonomike ashtu edhe për specialistët e fushave të ndryshme. Nga përvoja si pedagogë e bibliotekare kam vërejtur që nevoja për edukim i shtyn shpesh studentët të përqendrohet te mësimi i gjuhëve të huaja e më pak te ajo amtare. Pa përfshirë kostot e edukimit, lihen pas dore edhe leximet e ikonave të letrave në gjuhën shqipe.

Në lidhje me puritanizmin e kësaj çështjeje, pritjet me një artikull ose me disa nuk janë të mëdha, por një qasje drejt të përbashkëtave e trashëgimisë botërore në gjuhë dhe ndjeshmërinë që krijon vetë gjuha si mjet përbashkimi, mund të japim. Që gjithsecili krahas dobisë së kërkesës për programe që i mundësojnë lëvizjen në një botë globale, të gjejë të këndshme edhe zbulimin e fjalë me ortografi e shqiptim të njëjtë, a të përafërt,. Të tilla janë ndërkombëtarizmat.

Kur fillon e mëson një gjuhë të dytë të huaj njeriu bëhet lehtësisht një lloj eksperti në gjuhë dhe në kulturë. Meetaforikisht do të shpreheshim se në vend të pemës, ai që do të mësoj shikon kopshtin dhe aty vëren ngjashmëritë. Internacionalizmat janë të vjetra dhe të ngjashme në botën perëndimore dhe ato kryesisht nuk kërkojnë ndonjë shpjegim kur njeriu flet një ose dy gjuhë të tilla. Debati qëndron se çfarë quhen fjalë ndërkombëtare dhe natyrisht në varësi të gjuhës ky përkufizim ndryshon nga një gjuhë në tjetrën. Për shembull, në gjuhën angleze ky term nuk paraqet, pasi vetë anglishtja ka kontribuar në një numër fjalësh ndërkombëtare, p.sh terminologjia sportive, e kompjuterit etj.

Duke njohur përhapjen e gjerë të kësaj gjuhe, nisur nga fjalët çelës akademike të përdorur në *TOEFL book*¹, do të gjurmojnë ndërkombëtarizmat edhe në shqipe. Po ashtu edhe një listë huazimesh që i përkasin të njëjtës familje gjuhësore, por që paraqesin interes për njohjen si

¹ Essential Words for the TOEFL, Steven J. Matthiesen, 7th edition, 2017

shpejtësi e kalimit nga një gjuhë në tjetrën dhe që në shqipe mund të ruhen me vlera sinonimike si mjete e vlera që pasurojnë gjuhën.

Fjalori akademik është një klasë termash që përmbajnë shumë internacionalizma. Për disa prej tyre dihet se cila gjuha i përdori e para, ndërsa për të tjerat nuk është e gjurmueshme. Sekuenca kronologjike ka një rëndësi të kufizuar praktike, pasi pothuajse menjëherë pas origjinës së tyre ato u shfaqën në shumë gjuhë. Pa u ndalur në kohën kur ato u shfaqën mëtimi është sinkronik, por në mënyrë të përgjithshme mund të themi se në shqipe ato kanë bazë greko-latine, që për shkak të kontakteve historike i ka dhe të lehta për t'i bërë pronë të saj. **Metodologjia** e ndjekur është krahasuese -analitike ku ngjshmëritë e rrafshit të shprehjes kanë domethënie edhe për vetë përmbajtjen

2. Përkufizimi i ndërkombëtarizmave në gjuhën shqipe

Në lidhje me interesin e gjuhëtarëve shqiptarë për ndërkombëtarizmat në informon Josif Kole (Studime filologjike, Nr3. 1984). Autori duke e vënë në dukje vështirësinë e përkufizimit për to, nuk thotë se ato duhen mohuar. Duke sjellë vetëm ecurinë e mendimit gjuhësor shqiptar për to, siç raporton dhe Kole përpjekjet e para për të përcaktuar fjalët ndërkombëtare i gjejmë në shkrimet e A. Xhuvanit. “tue studiue gjuhën tonë, -ka vënë në dukje ai, shofim se prej influencës së gjuhëve të hueja u kanë futë në shkrimet tona shumë fjalë të hueja...p.sh...kulturë, plan, talent, kritikë, sistemë, programë, centralizëm, analizë, induksion etj. Këto fjalë...i kemi të përbashkëta edhe me gjuhët e tjera, janë ba ndërkombëtaare e nuk mund t’ua zëmë vendin me fjalë nga brumi i gjuhës sonë tue krijue fjalë të reja”.²”të tilla fjalë janë shumica e termave shkencorë si të kimisë, të fizikës, matematikës, biologjisë, filozofisë etj.; këto janë prej origjine greke e latine, janë bërë ndërkombëtare dhe përdoren të njëjta në të gjithë gjuhët e botës. Përveç këtyre ka edhe shumë fjalë të jetës ekonomike, politike, të arteve e të kulturës së përgjithshme (si fjalët natyrë...,socializëm, komunizëm, invalid, imperializëm, kapitalizëm, demokraci, asamble, realitet..., autokritikë,... kriter...etj) që edhe këto do t’i marrim po nga ai burim grek e latin ose neolatin, nga i cili i ka marrë gjithë bota.

Më pas, për një kohë, gjuhëtarë të tjerë, sa herë e ka sjellë rasti, janë mjaftuar vetëm me shprehjen e mendimit të tyre për praninë e fjalëve ndërkombëtare në gjuhën shqipe. Kështu p.sh., P.Geci ka theksuar se mjaft fjalë të njohura prej të gjithëve (p.sh. laborator, muskulaturë,eksport, import etj.) “i kanë edhe kombet e tjerë”³, ndërsa A.Krajni ka shprehur mendimin se zëvendësimi i turqizmeve të shqipes me fjalë të tjera të huaja nuk është i arsyeshëm”me përjashtim të rasës kur këto të fundit janë të përdorimit ndërkombëtar”⁴.

Vetëm në parathënienien e Fjalorit terminologjik të botanikës hasim një përcaktim për termat ndërkombëtare sipas së cilit të tillë quhen” ata terma që i kanë të përbashkët jo vetëm dy ose më shumë gjuhë neolatine...por që i kanë edhe gjuhët e tjera”⁵. Ky përcaktim është pranuar në heshtje, por edhe nuk është bërë ndonjë përkufizim tjetër. Por edhe ky përkufizim ka kufizimet e veta.

Ajo që duam të theksojmë më tepër në vlerësimin që i bën A. Kostallari fjalëve ndërkombëtare është dallimi që i bën ky autor të fjalëve të përbëra e të përngjitura të huazuara ka

² Shih A.Xhuvani, Vepra ,I,1980f.107

³ Shih P. gec, Pasuria e leksikut të shqipes dhe fjalori I gjuhës shqipe në “Buletin I universitetit Shtetëror të Tiranë, seria Shkencat shoqërore” 1959 Ose në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe” II, Tiranë, 1972, f.159

⁴ Shih A.Krajni, Hyrja e turqizmeve në shqipe dhe përpjekjet për zëvendësimin e tyre “Studime filologjike”, 1965 ose në “Studime mbi leksikun>>>>”, Tiranë, f.286

⁵ Fjalor I terminologjisë tekniko-shkencore, I,terminologjia e botanikës, Tiranë,1963,f.7

dalluar fjalë ndërkombëtare nga rrënjë greke e latine ose nga rrënjët e gjuhëve të tjera, si dhe rastet kur fjala tashmë ndërkombëtare ka ekzistuar si e përbërë ose e përngjitur që në gjuhët e burimit që në rastet, kur ajo është formuar më vonë (në gjuhët e reja) nga elementet e gjuhës greke e latine; ai është ndalur gjithashtu në pjesët e para dhe të dyta përbërëse të kompozitave ndërkombëtare.

Është me interes të sjellim në mëtin tonë vlerësimin që i bën Prof. Jani Thomaj ka pikëpamja e rëndësisë praktike të ndërkombëtarizmave, duke theksuar se ato përvetësohen më lehtë e zënë vend më shpjet në gjuhë e janë të qëndrueshme. Ai i ka shqyrtuar ndërkombëtarizmat nga sfera e përdorimit dhe nga origjina. Për sa i përket sferës së përdorimit ka dalluar sferën e jetës politiko-shoqërore, shkencën dhe tektnikën, artin, po ashtu dhe sferën e eksportit. Gjithmonë sipas këtij autori fjalët ndërkombëtare janë kryesisht me prejardhje nga greqishtja dhe nga latinishtja...pastaj ka dhe terma të ardhura nga gjuhë të tjera p.sh. nga italishtja..., frëngjishtja...nga anglishtja...etj.⁶ një autor si F.Leka i ka trajtuar sipas qëndrueshmërisë së tyre në gjuhën shqipe ato që janë bërë pronë e saj e të tjera që mund të zëvendësohen me fjalët tona e mund të shqipërohen. Përkufizmin më të ri në lidhje me ndërkombëtarizmat e gjejmë te Prof. Gjovalin Shkurtaj : si fjalë ndërkombëtare vështrohen ato fjalë që përdoren në shumicën e gjuhëve të botës (veçanërisht në gjuhët indoevropiane, por nuk do të quhen si të tilla (ndërkombëtarizma) fjalët që përdoren vetëm në gjuhët neolatine (italisht, frëngjisht). Për këto fjalë do të bëhen përpjekje të zëvendësohen me fjalët shqipe...⁷. Profesori gjithashtu vlerëson rolin e ndërkombëtarizmave në shqipen letrare të kohës sonë si mjete e vlera që pasurojnë leksikun.

M. Samara në një artikull rreth zhvillimive të reja të fjalëve me burim latin/roman në shqipen e sotme flet për ndjeshmërinë e shqipes ndaj faktorëve jashtëgjuhësorë dhe domethënien e tyre.⁸, ndjeshmëria gjuhësore shtohet sot ku pa përpundur shifra një numër i madh shqiptarësh brenda dhe jashtë vendit janë përdorues të italishtes, frëngjishtes e më pak gjermanishtes duke paraqitur një realitet gjuhësor multilingual.

Për të pasqyruar sipas një mënyre akademike situatën kemi paraqitur një tabelë të fjalëve me karakter ndërkombëtar gjetur TOEFL TEST, të paraqitura në një tabelë multilinguale, që pa përfshirë origjinën e tyre, nisur nga anglishtja janë paraqitur në gjuhët shqip. Italisht, gjermanisht, rusisht, rumanisht. Grupimi sipas dy a tri familjeve të ndryshme gjuhësore i vendos ato si ndërkombëtare, duke shtuar dhe faktin se gjuhët në shqyrtim janë gjuhë ndërkombëtare, funksioni dhe rëndësia e tyre është rritur të themi të paktën me një dekadë më parë. Vendosja pranë edhe rumanishtes si gjuhë ballkanike, e jep të plotë tablonë nisur dhe nga kriteret gjeografike. Qëndrimin në lidhje me mënyrën e ekzistencës së tyre apo të huazimeve do ta argumentojmë më poshtë, por vlerën paraktike të zinxhirit të kujtesës sonë e njohim të gjithë.

Natyrisht kur flitet për ndërkombëtarizmat kihet parasysh se ato janë të pranueshëm në disa gjuhë. Sipas gjuhëtarëve, numri i këtyre gjuhëve duhet të jetë jo më pak se dy gjuhë ndërkombëtare, të tjerë e rritin këtë në tri gjuhë ose në katër e ndonjëri në gjashtë “gjuhët e mëdha” të Evropës (anglisht, gjermanisht, frëngjisht, rusisht, spanjisht dhe italisht). Mendimi më i përgjithshëm është që bëhet fjalë për ndërkombëtarizma vetëm atëherë, kur ato takohen në formë e kuptim të ngjashëm ose të njëjtë në disa gjuhë që s’janë të njëjtin grup farefisnor e që përfaqësojnë dy a më shumë grupe të tilla ose familje gjuhësh. Dihet se shtrirja e një fjale nga një gjuhë në një tjetër e kthimi i saj në ndërkombëtarizëm, të shumtën përcaktohet nga vetë pesha e

⁶ Shih J.Thomaj, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë 1974, f.162

⁷ Shih Gj.Shkurtaj, Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe,Tiranë 2003, f. 128

⁸ M. Samara, studime filologjike, Nr.1-4, f.23, 1999

fjalës, nga vlera, nga rëndësia ose nga roli shoqëror i dukurisë, i sendit, i nocionit që shënohet prej kësaj fjale⁹. Nisur arsyetimi dhe argumentet e mësipërme, rëndësia dhe forcën e sotme e gjuhëve ndërkombëtare perëndimore, ne mund të themi se fjalët me karakter ndërkombëtar janë ato që përdoren në disa gjuhë ndërkombëtare, por me kusht që të paktën dy prej tyre t'i përkasin familjeve të ndryshme gjuhësore. Pa e çuar çështjen në parapëlqim kemi përdorur termin *fjalë me karakter ndërkombëtar* dhe jo *fjalë ndërkombëtare*.

1. Fjalë me karakter ndërkombëtar

Si ritmikë për jetën dhe kënaqësi për zgjedhjen fjalëve nga më të fuqishmet (karizëm, autonom, potencial etj) te ato të thjeshta në përdorim (transport, aspekt, aksion etj), po japin një shpërndarje të tyre sipas ngjashmërive të tyre në rrafshin e shprehjes, në gjuhët në shqyrtim.

Fjalë që kanë ngjashmëri grafemore me anglishten: *instaloj (install)*, sporadik* (sporadic); Me **gjermanishten**: *aksion (aktion)*, *atraktiv (attraktiv)*, *konstante (konstante)* *karizma (karizma)*, *kopleks (Komplex)*, *akut (akut)*; Me **italishten**: *fenomen (fenomena)*, *rafinat (rafinato)*, *intesifikoj (intesificare)*, *analizoj (analizzare)*, *intrig (intrigo)*, *imtesifikoj (intesificare)* edhe **rumanisten** (*uintedifica*); Me **frëngjishten**: *absurd*; **Rumanishten**: *interes (interes)*, *kronik (cronic)*, *klasifikoj (classifica)*, *ritëm (ritm)*, *partisan (partizan)*, *fenomen (fenomene)*, *praktik (praktik)*, *I rafinuar (rafinat)*, *analizoj (analiza)*, *intrig (intrigi)*, *rutina (rutina)*, *rezistent (rezistente)*, *sporadik (sporadic)*; me **rusishten** *intriga (intriga)*, *ritëm (ritm)*, *zhargon (zhargon)*, *partizan (partizan)*; me **gjermanishten dhe rumanishten**: *aspek t(aspekt)* , *autonomme; gjermanishten dhe anglishten : ekstrakt (extract)*

Shfaqjen pothuajse njëllor në të pesta gjuhët: *transport, potencial, ndërsa stanjacion* (stagnant) ndryshon vetëm me gjerm. *stagniert* dhe it. *Stagnante*. Parasysh trashëgiminë e shqipes nga leksiku roman themi se dhe huazimet e reja, të paktën siç duket kanë ngjashmëri grafemore e kuptimore me një gjuhë latine ballkanike siç është rumanishtja tregojnë se gjuha sikurse kulturat, përbashkohet mirë ku ka elemente të përbashëta gjeografike.

Tabela 1. Fjalë me karakter ndërkombëtar

anglisht	shqip	Italisht	frëngjisht	Rumanisht	gjermanisht	rusisht
aspect	aspekt	aspetto	aspetto	aspekt	aspekt	aspect
attractive	atraktiv	atraente	atrayant	atraktiv	attraktiv	privlekatelyy
interest	interesi	interesse	interet	interes	interesse	interesyy
autonomous	autonom	autonoma	autonome	autonom	autonom	avtonomnyy
chronic	kronik	Cronica/o	chronique	cronic	cronisch	khronicheskiy
action	Aksion (veprim)	azione	actiune	action	aktion	deystviye
constant	konstante	constante	Constant/e	constant	konstante	postoyanny
extract	ekstrakt	estratto	extrait	extrage	extract	izvlekat
transport	transporti	transporto	Le transport	transport	transport	transport
classify	klasifikoj	classificare	classer	classifica	klassifizieren	klassifitsirovat
export	eksport	esportare	exporter	export	export	eksport
install	instaloj	installare	installer	instalare	installieren	ustanovit
jargon	zhargon	gergo	jargon	jargon	jargon	zhargon
absurd	absurd	Assurda/o	absurde	absurd	absurd	absurdnyy

⁹ J. Kole, Mbi fjalët ndërkombëtare në gjuhën shqipe, studime filologjike, Nr. 3, 1984

humor	humor	umorismo	humor	umor	humor	yumor
charisma	karizma	carisma	charisme	carisma	karizma	kharizma
rhythm	ritëm	ritmo	rythme	ritm	rhythmus	ritm
partisan	partizan	Partigiana/o	partisan	partizan	partisan	partizan
phenomena	Fenomen dukuri	fenomeni	phenomens	fenomene	phanomene	yavleniya
Philanthropic	filantropik	Filantrpica/o	philanthropique	Filantropic		Filantropicheskiy
practical	praktike	Practica/o	pratique	praktik	praktisch	praktichnyy
refined	I rafinuar	Raffinata/o	Raffinee	rafinat	raffniert	izyskanny
analyze	analizë	analizzare	analyser	A analiza	analysieren	analizirovat
intesify	intesifikoj	intesificare	intesifier	intesifica	intensivieren	usilit
potential	potencial	potenziale	potentiel	potential	potenzial	potensial
stagnant	Statanjacion	stagnante	stagnant	stagnant	stagniert	zastoymy
complex	komplekse	Complessa/o	complexe	complex	komplex	slozhnyy
intrigue	intrigë	intrigo	intrigue	intrigi	intrigen	intriga
routine	rutina	routine	routine	Rutina ...	routine	rutina
resistent	rezistent	resistente	Resistant..	rezistente	resistent	stoykiu
acute	akute	Acuta/o	aigu	acut	akut	ostryy
sporadic	sporadik	Sporadic/o	sporadique	sporadic	sporadisch	sporadicheskiy
gigantic	gigant	Gigantesca/o	gigantesque	Gigantic		giganteskey
Dramatic	dramatike	dramatic/o	dramatic		Dramatisch	dramaticheskij

Në FGJSSH¹⁰ dhe Sinonimikun¹¹ gjejmë sinonime ose shpjegime fjalësh Sinonime: sporadic (*i rastësishëm*), acute –mjek. (*acarues, i menjëhershëm*), humor (*shaka, gjendje shpirtërore*), absurd (*e pakuptimtë*); Rezitent ~mjek. *rezistencë (qëndresë)*; rutinë (*punë e përditshme, bezditshme*), intrigë (fig spicë), edhe me çerdhe intrigues, intrigoj; complex (tërësi, grup), kompleks (e përbërë e ndërlikuar); potencial (fuqi, forcë), intesifikoj (shtoj, përshpejtoj, fuqizoj dhe intensifikohet (rritet), interes (dobi), analizë (zbërthim, koment, shqyrtim), praktik (i dobishëm), i rafinuar (ipastruar, i kulluar); fenomen(dukuri); partisan (guerrillas, pauses, ithtar), ritëm (rregullsi, gjallëri, rrahje, ecuri) ,klasifikoj (ndaj, rendis); transport (bartje, nisje etj)), ekstrakt (pjesë), aksion (veprim, letër me vlerë); kronike (e përleshme); autonome (mëvetësi); aspekt (pamje), Eksport (shitje jashtë shtetit) . Disa prej tyre kanë krijuar edhe çerdhe fjalësh në gjuhën shqipe, si: *humorizëm, absurditet, rezistoj, rezistencë, kompleksitet, intesifikim, interesoj, interesim, praktikoj, rafinoj, ritmikë, ritmikisht, transportues, transportim, transportoj, transportueshëm*.

Fjalë të tilla si *konstante* të përdorura gjerësisht në termonologjinë e fizikës (konstante gravitacionale nuk kanë përkthim në fjalorët tanë.) Ndërsa në fjalorin elektronik: *karizma(cilësi magjetike e personalitetit)*; zhargon (profesionale, e posaçme) dhe përdorimi i ri ligjërimor

¹⁰ FGJSSH, Toena, Tiranë 2002

¹¹ A.Dhrimo, E. Tupja, E. Ymeri, *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, Botimet EDFa, Tiranë 2007

atraktiv bisd. tërheqës.. Fjalwt e mwsipwrme fjalë gjejnë më mirë pasqyrim te Sinonimiku se te FGJSSH. Duhet theksuar se shkrimi elektronik nuk duhet t'i paraprirjë shkrimit fizik.

2. Fjalë të huaja me karakter jondërkombëtar

Qëndresa e gjuhës ndaj huazimeve qëndron në faktin e prirjes për qartësi që duhet të ketë gjuha. Sa më tepër fjalë të brumit të shqipes të ketë, aq më e lehtë dhe e kuptueshme bëhet ajo. Nga ana tjetër fjalë që ka hyrë në gjuhë është e vështirë të kaloj tërësisht pa lënë gjurmë. P.sh nëse do të kalosh një pasdite në një shesh të Brukselit apo të Romës, rutina të çon te pjacat, huazim i vjetër që përdoret edhe në shqipe për qendër e qytetit. Natyrisht që fjala *qendër* s'ka as ngjyrimin dhe as përmbajtjen e fjalës pjacë, si e tillë ajo duhet të vendoset te sinonimet. Fjalë të këtij lloji duhen gjurmuar, sepse ato ngelen në mendje e përmbledhin një pasuri urbanistike kulturore. Apo të tjera me ngjyrim të fortë emocional siç është fjala *brillant*.

Si fjalë ndërkombëtare në Wikipedia renditen të tilla si: *akademi, ananas, antenna, athlete, atom, automobile, ballerina, bar, blog, bus, cabin, cable, chocolate, coffe, colony, comedy, menu, microscope, microphone, motor, number, ok, olympiad, operation, party, portal, pedal, police, politics, psychology, radio, register, sandal, sardine, satan, sauna.*

Tabela 2: Fjalë me karakter jondërkombëtar.

anglisht	shqip	italisht	frenjisht	rumanisht
approval	Aprovoj (huaz)	aprovazione	approbation	aprobare
contemporary	kontemporan	Contemporanea/o	contemporaine	contemporan
negotiate	negocioj	negoziare	negocier	A negocia
woo	uau			woo
culminate	Kulminare/ kulminant	culminare	culminant	culminare
spectacle	spektakël	spettacolo	spectacle	spectacol
flux	fluks	Filantrpica/o		Fluche
advantage	avantazh	vantaggio	avantage	avantaj
confirm	konfirmoj	confermare	confirmer	A confirma
distributor	Distributor	distributore	Distributrice distributeur	distribuito
propoze	propozoj	proporre	proposer	propoze
determined	Determinues	determinata	Drtermine/e	determinat
compensation	kompesim	compensation	compesation	Compesare/ compensatsiya
curious	Kurioz kureshtar	Curiosa/o	Curieuse curieux	curios
superior	Superior epror	superiore	Superieure superieur	superior
spectacle	spektakël	spettacolo	spectacle	spectacol
brilliant	brilant	geniale	brillante	brilant

Krahasimi me gjuhët është gjithnjë i dobishëm. Nëse dikush me të vërtetë do t'i mësojë ato duhet t'i shohë në thellësi. P.sh fjala *woo*, e cila në rumanisht dhe në anglisht shfaqet njëllëj si

nga pikëpamja e shprehjes ashtu edhe e përmbajtjes, edhe në gjuhën shqipe *uau* ruan të njëjtin kuptim e konotacion, dhe përdoret gjerësisht si pasthirmë.

Nga leksiku neolatin dhe anglishten pa gjermanishten vijnë fjalët: aprovoj (miratoj), kontemporan (bashkëkohor), negocioj (s'ka sinonim të vërtetë, arrij një marrëveshje, kmpromis), gjigant (vigan, titan sipas sinonimikut) , kulminant (kulmoj, pika më e lartë), spektakël përveç sinonimit *shfaqje* ka kuptimin e *arritjes së shkëlqyer*. Sipas FGJSSH gjejnë shpjegim fjalë të tilla si; filantropik (*mirëbërësi*), avantazh konfirmoj (*vërtetoj, pohoj, miratoj, dakordësi*) ndërsa avantazh (*epërsi përparësi, dobi*); Propozoj (parashtroj, shpreh bis; *paraqis, kërkoj (për fejesë)*);brilant (*diamant*); dramatik (*teatror*) ;kompensim (*dëshpërblim, zhëmtim*); kurioz (*kureshtar*); superior me fjalën e prejardhur superioritet(*epërsi*)¹².Nga sa vëmë re edhe nga ky punim duhet përgëzuar puna e këtyre autorëve që kanë punuar për fjalorin sinonimik.

Fjalë si distributor (*agjent shpërndarës*) në e ligjrimim e ngjashme me kuptimin në gjuhën angleze) sipas fjalorit elektronik (mekanizës, pikë shpërndarje në karburantin e shitjes) dhe determinat (përcaktues), në librat e biologjisë së shkollave tona përdoret në togëfjalëshin faktor determinant.

4 Përfundime:

Në përfundim mund të themi se për vlerat që ka sot mësimi i gjuhëve të huaja në ndërtimin e një force intelektuale të levizshme dhe qëndrueshmërinë, fjalët me karakter ndërkombëtar të njohura si fjalor akademik duhet të njihen dhe të shkojnë paralelisht me procesin e mësimdhënies së shqipes ose gjuhës së huaj Kjo vjen edhe si rrjedhojë e zhvillimeve të reja të shoqërisë shqiptare dhe asaj globale kërkojnë një qasje të re ndaj gjuhës dhe kulturës gjuhësore. Pasaporta ndërkombëtare fillon me gjuhën amtare, por ajo sot, mw shumë se kurdo, është pjesë e familjes ndërkombëtare, ndaj është detyrë e çdo profesori të tërheqë vëmendjen e studentëve të tij për përhapjen e tyre në gjuhë, qofshin të vjetra ato apo edhe të reja fare si *karizmatik e atraktiv* që sot i përkasin ligjëritimit bisedor apo gjuhës së medias.

Në R.SH është miratura në klasën e dhjetë të AML Portofoli Evropiani Gjuhëve (Botimet Filara). Botimi Biografi Gjuhësore synon të dokumentojë përvojën gjuhësore në të nxënin e gjuhëve të huaja perëndimore, për të qartësuar qëllimet e mësimi të gjuhës së huaj, përmirësimin e aftësive gjuhësore dhe zgjerimin e njohurive për të kuptuar pupuj, kultura e vende të tjera. Mendoj se kësaj përvoje gjuhësore t'i shtohet edhe ajo e fjalëve të ngjashme që ata gjejnë në gjuhë të ndryshme, krahasuar edhe me shqipen. Kjo rrit si ndjeshmërinë e nxënësit, ashtu edhe të dhënat që na bashkojnë në familjen gjuhësore evropiane. Vjelja dhe kureshtia përkundrejt çdo fjalë që u duk e dobishme dhe që ka kuptim të qartë e bën më të hapur botën e tyre akademike.

Duke qenë se Essential words for TOEFL që është marrë si burim i parë i fjalëve (rreth 35 ndërkombëtare dhe 17 huazime) më karakter ndërkombëtar na e lehtëson sferën semantike të përdorimit të tyre, na ngelet që këtij studimi t'i shtojmë jetën e tyre në gjuhën shqipe. Gjuha e zemrës sonë është e lehtë dhe elastike përkundrejt jetës gjuhësore dhe shoqërore globale.Sa herë këto fjalë me karakter ndërkombëtar takohen shqipërimi i tyre ështëi nevojshëm dhe nuk e dëmton shqipen.

¹² Super –fjal.f.lib. parashtesë me të cilën ndërtohen fjalë për dicka që ndodhet mbi dicka tjetër... në ligjërimin bisedor sot përdoret si pasthirmë për të shprehur pëlqim.

Laryshia e gjuhëve dhe universaliteti i tyre janë objekte të mësimdhënies jo vetëm është i këshillueshëm, por edhe i domosdoshëm. Natyrisht del dhe nevojë pasqyrimi i tyre më i mirë në FGJSSH.

Referenca

- [1]. A.Dhrimo, E. Tupja, E. Ymeri, *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, Botimet EDFA, Tiranë 2007
- [2]. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalor i shqipes së sotme*, Toena, 2002.
- [3]. J. Kole, *Mbi fjalët ndërkombëtare në gjuhën shqipe*, Studime Filologjike, Nr. 3, 1984
- [4]. Gj. Shkurtaç, *Kahe dhe dukuri të kulturës shqipe*, Kristalina-KH, Tiranë 2003
- [5]. M. Samara, *Rreth zhvillimeve të reja të leksikut me burim latin/roman në shqipen e sotme*, Studime filologjike, Nr 1-4, 1996
- [6]. E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, Tiranë, 2002.
- [7]. E. Kapia, *Studime në gjuhësi teorike dhe të zbatuar*, Tiranë, 2015.
- [8]. E. Çabej, *Studime gjuhësore III*, fq 257.
- [9]. Essential Words for the TOEFL, Steven J. Matthiesen, 7th edition, 2017
- [10]. F. De Saussure, *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme*, Tiranë, 2002.
- [11]. Fjalët e formuara me parashtesa dhe prapashtesa K. Cipo i quan derivate, domethënë të prejardhura. *Gramatika shqipe, Tiranë 1949.*
- [12]. *Fjalori i Shqipes së Sotme*, Botime Toena, Tiranë, 2002.
- [13]. G. Belluscio, Sh. Rrokaj. *Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë.....Arbëria*, Tiranë 2011, f. 344-345.
- [14]. J. Thomaj, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008.
- [15]. J. Thomaj, M. Samara, H. Shehu, Th. Feka, *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2005.
- [16]. J. Thomaj, M. Samara, H. Shehu, Th. Feka, *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2005.
- [17]. J. Thomaj, *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, Tiranë 2009.
- [18]. J. Thomaj, *Teksti dhe gjuha*, Tiranë, 1992.
- [19]. Sh. Islamaj, *Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe*, Instituti albanologjik i Prishtinës, 1985.
- [20]. Sh. Islamaj, *Roli i sinonimisë në pasurimin e gjuhës, në “ Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve, në gjuhën shqipe III”*, Tiranë 1989, fq 359-366.
- [21]. Sh. Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe 2*, Tiranë, 2009.
- [22]. V. Memisha “*Ushtrime për Leksikologji dhe Semasiologji leksikore*” , Tiranë 2007.
- [23]. V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe I*, Tirane 2011.
- [24]. V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe II*, Tirane 2015.
- [25]. Xh. Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 1999.
- [26]. Xh. Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, Toena 1999.
- [27]. Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, 2005.